

**VENDIM**  
**Nr. 7, datë 10.7.2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 5, DATË 2.4.2019, TË KËSHILLIT PËR EMËRIME NË DREJTËSI, “PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATËVE, PËR POZICIONET VAKANTE NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, dhe të pikës 6, të nenit 240, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 5, datë 2.4.2019, të Këshillit për Emërime në Drejtësi, “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

**Neni 1**

Pika 62, ndryshohet, me përmbajtjen si vijon:

“62. Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm nga anëtarët e Këshillit. Avokati i Popullit merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në funksion të transparencës dhe besimit të publikut.”.

**Neni 2**

Në pikën 70, shtohen shkronja “c” dhe “d”, me përmbajtjen si vijon:

“c) që dosjet e kandidatëve të jenë të plota dhe në kopje të mjaftueshme për t’u shpërndarë tek organet e emërtesës; dhe

d) mënyrën e përcjelljes së listës përfundimtare organeve të emërtesës”.

**Neni 3**

Në pikën 75, pas shprehjes: “renditjes së kandidatëve”, shtohet shprehja: “mënyra e përcjelljes së tyre organeve të emërtesës”.

**Neni 4**

Në pikën 76, shprehja: “Menjëherë” zëvendësohet me shprehjen: “Brenda dy ditëve pune”.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARE**  
**Vitore Tusha**